



Prishtinë, 12.06.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2761_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2680_04_25** i datës 07.04.2025;
- Ankesa e konsumatorit e datës 26.06.2025.

në seancën e mbajtur më datë 12.06.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit L.J., të cilën me autorizim e përfaqëson i autorizuari i saj Av. Arbër Jashari, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2680_04_25 i datës 07.04.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 07.04.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2680_04_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatores L.J., lidhur me kërkesën për Lidhje të Përkohshme.

E pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatorja L.J., brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Shkalla e parë në ZRrE/DMK nuk e ka marrë fare për bazë kur e ka arsyetuar refuzimin e Lidhjes së Përkohshme të OSSh faktin që konsumatorja ka aplikuar për LP sipas Pëlqimit Parimor të lëshuar nga vet KEDS;
- OSSh-ja e ka bërë instalimin e shtyllave elektrike dhe ka vendosur njehsorin elektrik, por që, më pastaj ka ndërruar qëndrim dhe i ka refuzuar kërkesën për LP;
- Kërkon nga Bordi që, pa vonesa dhe në mënyrë urgjente të bëhet vendosja e njehsorit të ri, sipas kërkesës së aplikueses.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.06.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 26.05.2025; Vendimin e DMK të datës 07.04.2025; Ankesën e konsumatorit në KESCO të datës 22.11.2024; Përgjigjen e KESCO-s të datës 03.01.2025, Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 10.01.2025; Komunikimet elektronike ndërmjet DMK-së dhe aplikuesit si dhe komunikimet elektronike ndërmjet DMK-së dhe KEDS; Procesverbalin me nr. 2035099 i dt. 28.10.2024; Informatën e KEDS me nr. 11154 e dt. 14.08.2024; Pëlqimin Parimor të KEDS me nr. 613 e dt. 25.07.2024; Urdhër pagesën për taksa të kycjes dhe shërbimet e tjera, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Me datë 20.07.2023, përmes Fletëdorëzimit të kërkesës me nr. 1140707, aplikuesja L. J., ka aplikuar në KEDS/KESCO për Lidhje të Re, për kategorinë e konsumatorit shtëpiak 4/02, në paluajtshmërinë në fshatin Burrnik – Komuna e Ferizajt.

Me datë 25.07.2024, nga KEDS – Njësia e Shërbimeve me Konsumatorë, i ka lëshuar konsumatorit Pëlqimin Parimor me nr. 613, i dt. 25.07.2024, për konsumatorin F. E. J., me adresë në fshatin Burrnik, Komuna e Ferizajt, që ka të bëjë me dhënien e pëlqimit për rregullimin e dokumentacionit teknik për ndërtimin e vilave, në ngastrën kadastrale me nr. 00795-5, ZK Burrnik dhe se aplikuesja njoftohet që ky pëlqim i lëshohet për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe për nevoja të tjera nuk mund të përdoret. Më tej, njoftohet pala që ky pëlqim vlen 1 vit nga data e lëshimit, dhe se brenda këtij afati konsumatori obligohet ta sjell projektin e objektit për marrjen e pëlqimit energjetik. Konsumatori është njoftuar që, **para fillimit të ndërtimit të objektit të aplikojë për kycje të përkohshme**. Në të njëjtën datë konsumatori i është lëshuar edhe Urdhërpagesa për Taksat e Kycjes dhe Shërbimet e Tjera, në vlerë prej 171.10 €, të cilën konsumatori e ka paguar me datë 30.07.2024.

Ndërkaq me datë 14.08.2024, aplikuesja F. dhe L. J., nga KEDS – Njësia e Shërbimeve me Konsumatorë janë njoftuar si vijon: “Lidhur me kërkesën tuaj, përmes së cilës kërkon nga KEDS Pëlqim Elektroenergjetik (PEE) për kycjen e objekteve tuaja afariste (total 2 njësi me Pmnj(totale) = 224 kW) në rrjetin distributiv, KEDS e ka shqyrtuar lëndën tuaj dhe përmes kësaj informate iu njofton që, NS-et: NS 110/10kV Bibaj, NS 35/10kV Ferizaj II dhe NS 35/10kV Ferizaj III momentalisht nuk kanë kapacitet për kycje shtesë, mirëpo janë në Plan Investiv nga KOSTT për zgjerim të kapacitetit. Kështu që, kërkesa juaj do të mund të shqyrtohet pasi të bëhet zgjerimi i kapaciteteve energjetike nga ana e KOSTT-it. Pas zgjerimit të kapacitetit, KEDS do t’iu informojë në mënyrë që të aplikoni dhe të pajiseni me Pëlqim Elektroenergjetik për kycje të objekteve tuaja në rrjetin distributiv.

Me datë 03.01.2025, KESCO – Departamenti për Kujdes ndaj Konsumatorëve, i ka lëshuar një Vendim aplikuesit, përmes të cilit refuzohet kërkesa e tij, me arsyetimin se, konsumatori ka paraqitur kërkesë për PEE dhe nga KEDS e ka pranuar Informatën me nr. 11154 e datës 14.08.2024, sipas së cilës ju jeni informuar lidhur me rastin tuaj. Bazuar në procesverbalin nr.2035099 i dt. 28.10.2024, ekipet teknike të KEDS e kanë inspektuar vendin e ngjarjes dhe rezultoni që ju keni vendosur shtylla shtesë dhe keni bërë kycje të paautorizuar.



E pakënaqur me këtë Vendim, aplikuesja përmes përfaqësuesit të autorizuar Av. Arber Jashari, me datë 10.01.2025 i është adresuar DMK-së me Ankesë, lidhur me kërkesën për Lidhje të Re të parashtruar në KEDS. Ndër të tjera, në këtë ankesë, ka theksuar se aplikuesja i është drejtuar OSSH-së me kërkesë për Lidhje të Re të Përkohshme dhe se OSSH (KEDS) e ka bërë vendosjen e shtyllave të reja dhe kabllorëve të re, por që nga data 24.07.2024 nuk e ka bërë vendosjen e njehsorit elektrik. Nga data e aplikimit, vila e L. J., është duke u shërbyer me energji elektrike përmes gjeneratorit, çka shkakton barrë të papërbalueshme për të. Më tej, kërkon që OSSH (KEDS) pa vonesa dhe në mënyrë urgjente të bëjë vendosjen e njehsorit të ri tek shtëpia e kërkujes Liridona Jashari në fsh. Burrnik, Komuna e Ferizajt. Në rast se nuk realizohet kjo kërkesë, aplikuesja do t'i adresohet gjykatës për kompensim dëmi nga shfrytëzimi i gjeneratorit për sigurimin e energjisë.

Ndër të tjera prova materiale të elaboruara si më sipër, Bordi e ka shqyrtuar edhe Procesverbalin e Inspektimit, i hartuar nga punëtorët e autorizuar të KEDS me nr. 2035099, i dt. 28.10.2024, për aplikuesen Liridona Enver Jashari, me GT 4/02, me nr. të njehsorit 40151357, me gjendje të shpenzimeve prej TL = 175 kWh dhe TU = 83 kWh dhe në vërejtje të këtij procesi është evidentuar si vijon: ***“Konsumatorit i refuzohet kërkesa, sepse konsumatori ka vendosur shtyllat nga rrjeti i vjetër. Supozohet edhe është e vërtetë që konsumatori i ka zhvendosur shtyllat e betonit dhe i ka shtri edhe 3 të tjera. E ka ndërrua edhe kabllon, por konsumatori e ka ndërruar edhe trasenë, është kyç në një rrjet privat, të gjitha këto i ka bërë në mënyrë të paautorizuar – ilegalisht. Njehsori i merret, dhe i konfiskohet edhe kabllorë”***. Pra, nga sa mund të shihet, nga analizimi i këtij procesi rezulton që, konsumatori ka shtrirë rrjet në mënyrë të paautorizuar, i ka zhvendosur shtyllat e betonit, e ka ndërruar edhe trasenë dhe është kyçur në mënyrë ilegale në një rrjet privat. Rrjedhimisht, të gjitha këto veprime të konsumatorit janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, gjegjësisht, aplikuesja ka vepruar në kundërshtim me nenin 32 – Shfrytëzimi i pakontraktuar, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, si në vijim: ***“Konsumatori do të konsiderohet se shfrytëzon energji në mënyrë të pa kontraktuar nëse: 1.1. shfrytëzon energji në një mënyrë ose në sasi që nuk është si ajo që i është miratuar nga ndërmarrja e energjisë; 1.2. transmeton energji pas pikës matëse, në një vend tjetër, pa lejen e ndërmarrjes së energjisë, dhe ia përçon një shfrytëzuesi tjetër në një vend të ndryshëm nga vendi i kyçjes në rrjetë; 1.3. nuk nënshkruan kontratën me furnizuesin e energjisë brenda afatit të dhënë dhe vazhdon të shfrytëzojë energjinë pa kontratë. 2. Konsumatorët nuk duhet të ndryshojnë ose kryejnë ndonjë veprim në kyçe, pajisje matëse dhe aparate pa pëlqimin me shkrim nga ndërmarrja e energjisë, dhe janë të obliguar që të raportojnë te furnizuesi sapo të kuptojnë për ndonjë prishje të shkaktuar në kyçe dhe në pajisjet matëse”***.

Duke iu referuar dispozitave ligjore të Metodologjisë së Taksave të Kyçjes të Rrjetit të Shpërndarjes, gjegjësisht Kyçjes së Re të Thjeshtë – për t'u vlerësuar një kyçe si e tillë duhet të plotësohen në mënyrë komulative kushtet si në vijim: ka kapacitet total deri në 15kW, nuk ka nevojë për zgjerim dhe përforcim të rrjetit, kërkon instalimin e më pak ose deri në 4 njehsor, kërkon vendosjen e më pak ose deri në 2 shtylla dhe distancë më të vogël se 80 m. Rrjedhimisht, nga analizimi i projektit elektrik vihet re që, kërkesa e aplikueses ka të bëjë me dy njësi afariste me Pm_{nj} (totale) = 224 kW, dhe sipas kësaj metodologjie, kategorizohet si Kyçe e Thellë, si në vijim: ***“Kyçe e Thellë - nënkupton se Aplikuesi do të mbulojë me shpenzimet e veta kostot e aseteve të nevojshme për kyçe në pikën më të afërt të përshtatshme të kyçjes në sistemin ekzistues të shpërndarjes, plus çfarëdo kostosh indirekte që***



shkaktohen nga punë të ndërlidhura me përforcimin, zgjerimin apo ri-konfigurimin e rrjetit ekzistues e të cilat shkaktohen si pasojë direkte e operimit të Pikës së Kycjes” dhe konsumatorja duhet të aplikoj për PEE dhe ZT në KEDS. Lidhur me këtë çështje, Bordi thekson se, pasi që DMK ka kërkuar sqarime nga KEDS dhe të njëjtit e kanë konfirmuar faktin që, të gjithë aplikuesve për PEE dhe ZT për kycje në këtë zonë, janë duke u lëshuar këto dokumente, sepse kanë përfunduar investimet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit KOSTT në NS-et e caktuara.

Konsumatorja përmes përfaqësuesit të autorizuar insiston në Lidhjen e Përkohshme, dhe se lidhur me këtë çështje dhe duke iu referuar nenit 13.1 – Kycjet e Përkohshme të Metodologjisë së Taksave të Kycjes, si vijon: **“OSSH mund të sigurojë një lidhje të përkohshme për të furnizuar me energji elektrike kompanitë për ndërtim që po ndërtojnë një shtëpi të re, objekte kolektive banesore apo objekte të biznesit. Kërkesa për kycje të përkohshme mund të bëhet nëpërmjet kompanisë për ndërtim. Një lidhje e përkohshme do të regjistrohet si konsumator komercial për një afat maksimal prej 180 ditësh, çfarëdo zgjatje do të rikonfirmohet përmes aplikimit dhe ndjekjes se procedurës për kycje të përkohshme. Të gjitha instalimet e bëra nga ana e aplikuesit deri në pikën e kycjes, janë përgjegjësi e kompanisë për ndërtim. Palët e treta nuk mund të përfitojnë nga lidhja e përkohshme. Nëse transformatori dhe linja e furnizimit nuk janë instaluar në mënyrë të përhershme, pasi të jetë përfunduar aktiviteti për kycje të përkohshme, instalimi do të çmontohet nga kompania për ndërtim. Pas përfundimit të kycjes së përkohshme, Aplikuesi rezident duhet të aplikoj për kycje të përhershme në pajtim me dispozitat ligjore të kësaj Metodologjie”.**

Më tej, në paragrafin 7 përcaktohet si vijon: **“Kur kërkesa për kycja të re e tejkalon kapacitetin e disponueshëm të rrjetit (përveç dispozitës të paraparë në nën-paragrafin 1.7 të këtij neni), atëherë Aplikuesi duhet të ngarkohet për kapacitetin e tij të nevojshëm për kycje, përderisa OSSH bënë rritjen e kapacitetit të rrjetit, si dhe nëse aplikuesi zgjedh OSSH për të kryer punimet për ndërtimin e rrjetit, atëherë Aplikuesi paguan taksën për shërbim të kycjes, taksën për kapacitet (vetëm për pjesën e përforcuar) dhe taksën për punë të ndërtimit të rrjetit elektrik, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes KEDS, ka vepruar në harmoni me këtë rregullativë ligjore, ashtu që, me të drejtë ka vendosur për refuzimin e kërkesës për LP. Ndërkaq, lidhur me kërkesën për PEE dhe ZT, duke qenë se aktualisht ka kapacitete të lira, udhëzohet konsumatorja që të aplikoj të Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për t’u pajisur me këto dokumente dhe se punimet duhet t’i realizoj konform këtyre dokumenteve.**

Përfundimisht, Bordi i ZRrE-së, e rikonfirmon qëndrimin se, Lidhja e Përkohshme, i sigurohet konsumatorit/aplikuesit vetëm gjatë procesit të ndërtimit të objektit/shtëpisë ose objekteve biznesore, dhe se nuk mund të aplikohet për Lidhje të Përkohshme për furnizim të rregullt me energji elektrike pas finalizimit të objektit, si në rastin e konsumatores. E njëjta me të drejtë është njoftuar nga DMK që, për t’u furnizuar me energji elektrike, për objektin e saj afarist, duhet të aplikoj për Pëlqim Elektroenergjetik dhe Zgjidhje Teknike, sipas legjislacionit në fuqi. Po ashtu, e njëjta e hesht në tërësi faktin që ka bërë shtrirje dhe kycje të paautorizuar në rrjetin e energjisë elektrike, në kundërshtim me ligjet e aplikueshme. Rrjedhimisht, ankesa e konsumatorës është e pabazuar andaj edhe e njëjta refuzohet në tërësi.



Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët, e në veçanti kërkesave të aplikuesit, Pëlqimit Elektroenergjetik dhe Zgjidhjes Teknike, Përgjigjes së KEDS, si dhe dokumenteve të tjera relevante, si dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Shpërndarjes së OSSH-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **L. J., (Av. Arber Jashari)** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.